



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**

PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMIN E LIRIMIT

LËNDA

“GJUHË SHQIPE”

KOORDINATORE: ERIDA KOLECI

VITI SHKOLLOR 2016 - 2017

1. UDHËZIME TË PËRGJITHSHME

Programi orientues i gjuhës shqipe është një dokument i vlefshëm për nxënësit e klasës së nëntë, për mësuesit dhe për specialistët e përfshirë në procesin e vlerësimit të Provimeve të Lirimit.

Programi orientues përfshin konceptet, njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të lëndës, përvetësimi i të cilave siguron suksesin e nxënësve në testin e gjuhës shqipe në Provimet e Lirimit.

Ky program orientues është mbështetur në programet e gjuhës shqipe për klasat 6-9;

1.1. Synimet e programit orientues

Programi synon:

- të ndihmojë nxënësit në përgatitjen e tyre për Provimin e Lirimit;
- të ndihmojë mësuesit e gjuhës shqipe në punën e tyre për zbatimin e programit, si dhe për t'u dhënë udhëzimet e duhura nxënësve;
- të orientojë specialistët që merren me hartimin dhe me vlerësimin e testeve në Provimet e Lirimit.

1.2. Kërkesa që duhen marrë parasysh për testin e provimit të gjuhës shqipe

Nxënësi testohet për aftësitë intelektuale, të cilat janë të vëzhgueshme, të matshme, të synuara nga programi dhe të zhvilluara në lëndën e gjuhës shqipe, si:

- aftësia për të identifikuar dhe për të kuptuar (nivel bazë);
- aftësia për të analizuar dhe për të zbatuar (nivel mesatar);
- aftësia për të vlerësuar, për të gjykuar dhe për të mbajtur qëndrime të caktuara (nivel i lartë).

1.3. Përqindja e pikëve në test për secilin nivel

Nivelet e aftësive intelektuale		
Niveli bazë	Niveli mesatar	Niveli i lartë
40%	40%	20%

1.4. Struktura e testit

Pjesa e parë: Tekst letrar

Pjesa e dytë: Tekst joletrar

Pjesa e tretë: Pyetje për njohuritë rreth sistemit gjuhësor

Fragmentet ose tekstet në test janë të panjohura për nxënësit dhe nuk janë pjesë e teksteve mësimore. Pyetjet për tekstet ose për fragmentet testojnë aftësinë e nxënësit për të kuptuar, analizuar, reflektuar dhe gjykuar mbi to.

2. OBJEKTIVAT E PROGRAMIT ORIENTUES SIPAS LINJAVE

2.1. LINJA: Të lexuarit

Nxënësi të jetë i aftë:

- të grupojë pjesët që lexon sipas gjinive dhe llojeve letrare;
- të identifikojë ngjarjet ose çështjet kryesore në një tekst;
- të krahasojë pjesë të ndryshme brenda tekstit;
- të gjejë një titull tjetër, të ndryshëm nga titulli i tekstit të dhënë;
- të lexojë duke shpjeguar *grafikët, tabelat, pikturat dhe shenja* të tjera, me të cilat shoqërohen tekstet;
- të dallojë në një tekst jo më pak se tri elemente karakterizuese për personazhet, mjediset, gjendjet, veprimet, marrëdhëniet etj.;
- të listojë tiparet e personazheve që pëlqen, duke e mbështetur mendimin e tij me argumente;
- të zbërthejë me imagjinatë domethënien e teksteve të ndryshme;
- të zbulojë mesazhin në një tekst të dhënë;
- të komentojë fragmente të ndryshme përmes analizave të tekstit;
- të përmbledhë idetë dhe të mbajë qëndrim kritik ndaj tyre;
- të interpretojë qëllimet e autorit në tekst;
- të dallojë figurat stilistike si: *personifikimi, antiteza, krahasimi, hiperbola, metafora*;
- të zbërthejë figurat stilistike duke treguar funksionin shprehës të tyre;
- të identifikojë kuptimin e parë dhe të figurshëm të fjalëve;
- të dallojë dhe të analizojë elemente të thjeshta të vargëzimit, gjatë analizave të teksteve letrare;
- të dallojë tiparet kryesore të gjuhës dhe të stilit të shkrimtarit;

- të analizojë dhe të vlerësojë gjuhën e një teksti.

2.2. LINJA: Të shkruarit

Nxënësi të jetë i aftë:

- të shkruajë për lexues të ndryshëm: mësues, prindër, shokë, të afërm;
- të shkruajë për të dhënë informacion për të tjerët, nëpërmjet përshkrimit dhe argumentimit;
- të përshkruajë përvoja vetjake dhe veprimtari të kryera në grup;
- të përshkruajë dukuri të natyrës sipas këndvështrimit të tij imagjinar;
- të hartojë me shkrim zgjidhje për situata të ndryshme;
- të përshkruajë heronjtë e tij imagjinarë duke përdorur fjalorin e duhur;
- të shkruajë ese argumentuese;
- të shkruajë ese përshkruese;
- të shkruajë përmbledhje;
- të shkruajë një mbyllje tjetër, të ndryshme nga varianti i dhënë;
- të shkruajë fletë ditari, letër formale dhe joformale;
- të zbatojë kërkesat gjuhësore sipas llojit të shkrimit.

2.3. LINJA: Njohuri të sistemit gjuhësor

Nxënësi të jetë i aftë:

- të dallojë klasat e fjalëve;
- të përcaktojë gjininë, numrin dhe rasën e emrit;
- të dallojë gjininë, numrin, rasën dhe shkallën e mbiemrit;
- të përcaktojë formën, mënyrën, vetën, numrin, kohën e foljeve;
- të dallojë foljet *kam* dhe *jam* me funksion të mëvetësishëm dhe ndihmës;
- të dallojë format e pashtjelluara;
- të përcaktojë funksionet e formave të pashtjelluara;
- të përcaktojë llojin e përemrave;
- të përcaktojë veçoritë gramatikore të përemrave të ndryshëm;
- të dallojë trajtat e shkurtra dhe të bashkuara (tri pozicionet);
- të dallojë pjesëzën *u* të joveprores nga trajta e shkurtër *u*;
- të dallojë përemrin vector të vetës së tretë nga përemri dëftor;
- të dallojë ndajfoljen dhe të përcaktojë llojin e saj;

- të dallojë lidhëzat;
- të dallojë parafjalët;
- të dallojë fjalët sipas formimit: të thjeshta dhe jo të thjeshta (të prejardhura, të përbëra, të përngjitura);
- të ndërtojë familjen e fjalëve të ndryshme me jo me pak se 4 fjalë;
- të analizojë fjalën sipas ndërtimit;
- të analizojë fjalën sipas fjalëformimit;
- të krijojë çifte sinonimie dhe antonimie;
- të dallojë shprehjet frazeologjike;
- të përcaktojë llojin e fjalisë sipas kumtimit dhe intonacionit;
- të tregojë llojin e fjalisë sipas ndërtimit (përbërjes);
- të tregojë llojin e fjalisë sipas modalitetit: mohore, pohore;
- të përcaktojë llojin e fjalisë sipas qëllimit të thënies: dëftore, pyetëse, nxitëse, dëshirore, thirrmore;
- të tregojë llojin e fjalisë sipas gjymtyrës kryesore: dykryegjymtyrëshe dhe njëkryegjymtyrëshe;
- të përcaktojë llojin e fjalisë së përbërë me bashkërenditje dhe me nënrenditje;
- të ndërtojë skemën e një fjalisë të dhënë;
- të shndërrojë fjalinë e thjeshtë në të përbërë;
- të emërtojë funksionet gramatikore të gjymtyrëve (kryefjalë, kallëzues, përcaktor, kundrinor, rrethanor) në një fjali të dhënë dhe të përcaktojë se me çfarë shprehen;
- të përcaktojë llojet e kundrinorëve;
- të përcaktojë llojet e përcaktorëve;
- të përcaktojë llojet e rrethanorëve;
- të dallojë ligjëratën e drejtë nga e zhdrejta;
- të përdorë saktë shenjat e pikësimit brenda dhe në fund të fjalisë;
- të përdorë saktë shkronjën e madhe;
- të shkruajë drejt bashkëtingëlloret e zëshme në trup dhe në fund të fjalës;
- të përdorë saktë bashkëtingëlloret nistore: *sh, zh, ç, s, z*;
- të përdorë drejt zanoret: *e, ë, i/y, u/y*;
- të përdorë drejt nyjën e përparme të mbiemrat;
- të shkruajë drejt fjalët kur takohen dy shkronjave të njëjta;

- të shkruajë saktë fjalët që përmbajnë grupet e zanoreve: *ye, ua, ie*;
- të shkruajë saktë datat;
- të shkruajë drejt fjalët që mbarojnë me: *-ër, -ërr, ël* në shumës.

2.4. Konceptet kryesore të kësaj linje janë si më poshtë:

Nënlinjat	Konceptet
Sintaksë	<ul style="list-style-type: none"> - Kryefjala - Kallëzuesi - Përcaktori - Rrethanori - Kundrinori - Grupi emëror - Grupi foljor - Fjalë e thjeshtë sipas kumtimit dhe gjymtyrëve - Fjalë e përbërë me bashkërenditje dhe nënrenditje
Morfologji	<ul style="list-style-type: none"> - Klasat e fjalëve - Emri - Mbiemri - Përemri - Folja - Ndajfolja - Parafjala - Lidhëza
Leksikologji dhe fjalëformim	<ul style="list-style-type: none"> - Fjalëformimi - Sinonimet dhe antonimet - Familja e fjalëve - Shprehjet frazeologjike
Drejtshkrim	<ul style="list-style-type: none"> - Shkrimi drejt i fjalëve, i numrave dhe i datave - Shenjat e pikësimit

3. TABELA E PESHËS SPECIFIKE SIPAS LINJAVE

Nr.	Linja	Përqindja
1	Të lexuarit	45 %
2	Të shkruarit	15 %
3	Njohuri rreth sistemit gjuhësor	40 %